



KËSHILLI KOORDINUES I DIASPORËS

22 Maj 2020

Këshilli Koordinues i Diasporës (KKD), si institucion që ka për detyrë të përfaqësojë interesat e diasporës dhe të jetë një urë lidhëse me institucionet e vendlindjes, është duke ndjekur me kujdes zhvillimet e fundit në Shqipëri. KKD konsideron se respektimi i të drejtave të shtetasve shqiptarë dhe i parimeve të demokracisë është një përgjegjësi thelbësore për shtetin shqiptar në rrugën drejt antarësimit në Unionin Evropian. KKD ka ndjekur me shqetësim të veçantë situatën e krijuar nga shëmbja e godinës së Teatrit Kombëtar. Mënyra dhe momenti që u zgjodh nga qeveria për të prishur godinën, shoqëruar me arrogancën kundër atyre me medim ndryshe, n'a shqetëson pasi vihet seriozisht në diskutim e ardhmja e Shqipërisë si një shtet demokratik. Është e pakuptueshme se si në çastet e rënda të pandemisë, një nga prioritetet e qeverisë ishte prishja e Teatrit Kombëtar. Shoqëria shqiptare në këtë periudhë të paprecedent ka nevojë për qetësi dhe unitet dhe jo veprime të nxituara dhe konflikte të panevojshme. Për më shumë, dhuna e ushtruar nga forcat e rendit kundër protestuesve ditën e shëmbjes së Teatrit Kombëtar duhet analizuar si akt i shëmtuar dhe aspak demokratik. KKD, edhe pse i miratuar nga qeveria e Shqipërisë, është institucion i pavarur. Shumë prej nesh ndodhen larg atdheut jo vetëm si pasojë e zgjedhjes individuale, por edhe e trajtimeve megallomane dhe shpesh hakmarrëse të qeverive të ndryshme. Dhe kjo për vendin tonë ka qenë me kosto të lartë, sidomos intelektuale. Ne dënojmë pa asnjë rezervë veprimet e qeverisë për shëmbjen e Teatrit Kombëtar, mungesën e transparencës, shkeljet ligjore, dhe nxitimin në marrjen e vendimeve. Ndërkohë, u bëjmë thirrje forcave politike në Shqipëri që të zhvillojnë dialogun dhe jo arrogancën e treguar deri tani. Bëjmë thirrje të ndalet menjëherë ndjekja penale kundër personave të arrestuar e dhunuar në protestën e datës 17 Maj, ndjekje penale ndoshta duhet rezervuar për ata që urdhëruan shëmbjen dhe ushtruan dhunën. KKD e konsideron thelbësore transparencën dhe respektin e ligjit në procesin e vendimmarrjeve të qeverisë dhe distancohet nga veprimet e nxituara dhe që karakterizohen nga mungesa e dialogut dhe mosrespektimi i institucioneve të drejtësisë. Kërkojmë nga ekzekutivi që e drejta e popullit për protesta të respektohet dhe që forcat e rendit të veprojnë vetëm konform ligjit. Ngjarje të tilla me karakter të rrezikshëm për demokracinë e vendit e bëjnë edhe më urgjente marrjen e mendimit të diasporës në qeverisjen e vendit.



E drejta e votës së shtetasve shqiptarë në diasporë është një e drejtë e garantuar me kushtetutë por që vazhdon të mohohet. KKD e konsideron jetike për demokracinë në Shqipëri që kjo e drejtë thelbësore t'iu mundësohet shtetasve shqiptarë në diasporë dhe i kërkon shtetit shqiptar dhe gjithë partive politike të ndërmarrin të gjitha veprimet e duhura dhe të parashikuara me ligj që diasporës t'i garantohet pjesëmarrja në zgjedhjet e planifikuara për vitin 2021. Është detyrë e parlamentit t'i sigurojë diasporës të drejtën kushtetuese për të votuar ose diaspora do të ri-konsiderojë mardhënjet e saj me qeverinë e vendin amë.